



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:089305

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06341955

C.nr.782/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.S. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson A.L. nga Prishtina, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 1,500.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 24.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

I. REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N.S. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të “OBLIGOHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Illyria”, me seli në Prishtinë, që paditësit, t’ia kompensoj shumën prej 1,500.00 euro, në emër të dëmit material dhe dëmin jomaterial si pasojë e lëndimeve për të gjitha kategoritë e dëmit, të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 30.03.2021, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm dhe të OBLIGOHET e paditura, që paditësit t’ia paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi N.S. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj, av. D.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria”, me seli në Prishtinë, sheshi “Nëna Terezë”, nr. 33, të cilën me autorizim e përfaqëson A.L. nga Prishtina, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 1,500.00 euro.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, gjykata më datë 23.10.2024 ka caktuar shqyrtimin kryesor, në të cilin ka prezantuar i autorizuari i paditësit, i cili ka deklaruar se me palën e paditur kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore, andaj në përputhje me nenin 149 të LPK-së, gjykatës i ka propozuar që të nxjerrë aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit, në përputhje me nenin 149 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së, që secila palë t’i bartë shpenzimet e saj procedurale.

Numri i lëndës: 2021:089305
Datë: 24.10.2024
Numri i dokumentit: 06341955

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.782/2021 të datës 24.10.2024

Gj y q t a r i
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.